



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8256 prot.

Roskovec, më 01 . 10 . 2025

VENDIM

Nr. 33, datë 30 / 09 / 2025

PËR

**DHËNIEN ME QIRA TË AMBIENTEVE PÛRKATËSE PËR T'U PËRDORUR SI
ZYRA ADMINISTRATIVE NGA SHOQËRIA RAJONAL UJËSJELLËS
KANALIZIME FIER SHA**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 9, nenit 54 shkronja “e/1”, të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, VKM-së Nr. 1210 datë 11.12.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kuman, të Qarkut të Fier”, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Kërkesës Nr. 7131 prot. datë 26.08.2025 të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sha, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Dhënie me qira të ambienteve përkatëse për t'u përdorur si zyra administrative nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier ShA.
2. Miratohet që të vendoset në funksion të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier ShA, për t'u përdorur si zyra administrative, Pasuria me Nr. 99, Zona Kadastrale 2326, e cila është në pronësi të Bashkisë Roskovec, sipas inventarit të pronave të Bashkisë Roskovec.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit që të vijojnë me procedurat e hartimit të Kontratës së qirasë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka

